

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 437/Prot.

Tiranë, më 14/08/2011

URDHËR

Nr. 398, datë 10/08/2011

PËR

HAPJEN E FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" TË VLORËS, RIORGANIZIMIN E PROGRAME TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" DHE HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" NË KËTË FAKULTET

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 8, 26, 41 dhe 42 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, të Fakultetit të Shëndetit Publik.
2. Në strukturën e Fakultetit të Shëndetit Publik do të përfshihen këto njëzi bazë:
 - 2.1. Departamenti i Infermierisë
 - 2.2. Departamenti i Kujdesit të Nënës dhe Fëmijës
 - 2.3. Departamenti i Shëndetit Publik
3. Fakulteti i Shëndetit Publik të fillojë të funksionojë nga data 1 shtator i vitit 2011.
4. Riorganizimin, në Fakultetin e Shëndetit Publik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, të programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në:
 - a. Infermieri i Përgjithshëm, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në "Infermieri të Përgjithshme"
 - b. Infermieri Mami, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në "Infermieri Mami"
5. Hapjen, në Fakultetin e Shëndetit Publik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, "Master Profesional" në:
 - a. Infermier Patolog, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Master Profesional", "Infermier Patolog".
 - b. Infermier Pediatër, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Master Profesional", "Infermier Pediatër".

6. Programet e studimeve "Bachelor" realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike.
7. Programet e studimeve "Master profesional" realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.
8. Efektet Financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, pa efekte buxhetore shtesë.
9. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të MASH, si dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

MYQEREM TAFAJ


MINISTËR

